STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 25 nëntor 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON NJE GRANT FEDERAL PREJ 27 MILIONE DOLLARE PER TE FUTUR NE PUNE ME SHUME SE 5,000 BANORE TE PAPUNE TE NJU JORKUT NE PASTRIMIN PAS URAGANIT SENDI (SANDY)

Fondet do të ndihmojnë që rajonet të punësojnë të rinj dhe të papunët për të punuar në përpjekjet e pastrimit pas Uraganit Sendi (Sandy)

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se shteti ka siguruar një grant federal prej 27 milionë dollarë që do të ndihmojë për të futur në punë më shumë se 5,000 banorë të papunë të Nju Jorkut për të ndihmuar në pastrimin e komuniteteve që ende po rimëkëmben nga Urgani Sendi (Sandy).

Financimi - i siguruar nga Granti i Emergjencave Kombëtare - do t'u sigurohet komuniteteve të goditura më rëndë nga stuhia, në mënyrë që të punësojnë shpejt të rinj dhe të papunët për të ndihmuar në përpjekjet e pastrimit në qarqet e prekura, përfshirë Bronxin (Bronx), Kings (Kings), Naso (Nassau), Nju Jork (New York), Oranxh (Orange), Putnëm (Putnam), Kuins (Queens), Riçmond (Richmond), Roklënd (Rockland), Safolk (Suffolk), Sallivën (Sullivan), Ulstër (Ulster) dhe Uestçester (Westchester). Departamenti i Punës i Shtetit, që është duke administruar fondet, do të punojë me komunitetet për të identifikuar rajonet e pastrimit dhe për të vendosur punëtorët në vendet e punës.

"Ndërsa Shteti i Nju Jorkut fillon rindërtimin dhe pastrimin pas shkatërrimit të pabesueshëm të shkaktuar nga Uragani Sendi (Sandy), sasia e madhe e punës për t'u bërë na jep një rast t'u sigurojmë banorëve të rinj dhe të papunëve të Nju Jorkut mundësi pune në pastrimin e komuniteteve të tyre," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Ky financim jo vetëm do t'u sigurojë të rinjve dhe të papunëve mundësinë për të marë pjesë në pastrimin dhe rindërtimin e komuniteteve të shkatërruar nga stuhia, por do të sigurojë përvojë të vlefshme pune dhe trainim në punë që mund të jetë i dobishëm në karriera të ardhshme."

Përveç kësaj, Guvernatori Kuomo (Cuomo) njoftoi sot se shteti në partneritet me Agjencinë Federale të Administrimit të Emergjencave (FEMA) do të fillojë programin e pajtimit në punë vendor për të zëvendësuar punonjës të FEMA-s, që shpesh janë nga jashtë shtetit, me banorë të Nju Jorkut. Qëllimi është të pajtohen në punë mbi 700 banorë të Nju Jorkut.

“Një nga mënyrat për të ndihmuar rimëkëmbjen e Nju Jorkut është të përfshijmë vetë banorët e Nju Jorkut në rindërtimin e komuniteteve të tyre,” tha Punonjësi i Bashkërendimit Federal Majkëll F. Bërn. “Do të kemi një rimëkëmbje më të fortë duke patur punonjës që janë të interesuar personalisht në suksesin e saj.”

BERJA E KERKESES PER NJE VEND PUNE

Departament i Punës do të ndihmojë komunitetet vendase për të identifikuar dhe pajtuar në punë punëtorë. Individët që janë të interesuar në bërjen e kërkesës për një vend pune sipas këtij granti inkurajohen të kontaktojnë Departamentin e Punës në 1-888-4-NYSDOL (1-888-469-7365) ose duke shkuar në www.labor.ny.gov/sandyjobs. Individët gjithashtu mund të shkojnë në Qendrën e Rimëkëmbjes nga Katastrofa ose Qendrën me Një Ndalim të Karrierës vendore të tyre.

Të gjithë individët duhet të jenë të papunë që të kualifikohen. Pasi pajtohen në punë, punëtorët do të fitojnë rreth 15 dollarë në orë për të punuar në projekte me afat të shkurtër dhe afat të gjatë. Puna do të përfshijë pastrimin dhe riparimin e strukturave dhe pasurisë publike të dëmtuar në secilën nga nëntë qarqet e shpallura rajone të katastrofës.

Përveç dhënies së përfitimeve dhe përvojës në punë, secilit punëtor do t’i jepet ndihmë për të gjetur vendin e tyre të ardhshëm të punës. Të rinjtë që kualifikohen gjithashtu do të çertifikohen në programin e Guvernatorit Punët e të Rinjve të Nju Jorkut (New York Youth Works).

PUNET E FEMA-s

Individët e interesuar për të bërë kërkesë për një vend pune me FEMA-n duhet të shkojnë në faqen në internet të Guvernatorit Kuomo (Cuomo) Punët Ekspres në http://www.labor.ny.gov/jobs/regional.shtm

Funksionet me kohë të plotë të përkohëshëm variojnë nga Specialistë të Marrëdhënieve me Komunitetin që sigurojnë ndihmë për komunitetet e goditura nga katastrofa tek ndihmësa administrativë.

IDENTIFIKIMI I VENDEVE

Guvernatori Kuomo (Cuomo) ka udhëzuar Departamentin e Punës që të kontaktojë menjëherë zyrtarë publikë vendorë në rajonet e prekura për të identifikuar vendet në nevojë dhe për të dërguar ekipet e pastrimit dhe të rindërtimit. Zyrtarët publikë vendorë gjithashtu mund të paraqesin informacionin mbi projektet dhe vendet e projektit pranë Departamentit të Punës duke dërguar e-mail në: sandyprojects@labor.ny.gov.

Departamenti i Punës i Shtetit me shërbimet e tij të ripunësimit dhe qendrat me një ndalesë të karrierës anembanë rajoneve të prekura do të punojë fort për të lidhur banorët e papunë të Nju Jorkut me vende

pune të tjera. Pas Uraganit Sendi (Sandy), kërkesat për sigurim të papunësisë të lidhura me stuhinë janë rritur në pothuajse 50,000.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418